

Dita Botërore e Refugjatëve

[Narrator]

Dita Botërore e Refugjatëve shënohet çdo vit më 20 qershor. Kjo është një ditë për të reflektuar mbi situatën e miliona njerëzve të zhvendosur me forcë në të gjithë botën. Përkujtimi vjetor është shënuar me një shumëllojshmëri të ngjarjeve në më shumë se 100 vende, përfshirë zyrtarë qeveritarë, punëtorë humanitarë, të famshëm, civilë dhe vetë të zhvendosurit.

Narasimha Rao është Shef i Misionit të Agjencisë së OKB-së për Refugjatë

[Z. Narasimha Rao, Shef i Misionit të UNHCR-it në Kosovë]

Më 20 qershor shënohet Dita Botërore e Refugjateve për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të njoftuar popullatën në botë për vuajtjet e personave të zhvendosur. Në Kosovë, shifrat që ne po flasim janë mjaft të ulëta krahasuar me atë që po ndodhë në botë, por është e padrejtë për popullatën e zhvendosur që edhe pas 15 - 16 viteve, ne jemi ende duke diskutuar zgjidhjet për ta. Ne kemi rreth tetë mijë apo më shumë persona të cilët duhet të kthehen nga Serbia, rreth dy - tre mijë nga Mali i Zi dhe rreth disa qindra nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë.

Ka një bashkëpunim shumë të mirë në mes të institucioneve të Kosovës dhe qeverive në rajon si Serbia, Mali i Zi, dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe shpresojmë që ky bashkëpunim të sjellë zgjidhje për këtë popullatë në vendin e zhvendosjes dhe kthimin e tyre përsëri në vendin e tyre para zhvendosjes.

Ne shpresojmë se do të mund të kthejmë rreth tetë mijë apo më shumë persona nga Serbia, tre mijë apo më shumë nga Mali i Zi dhe ashtu siç thashë më parë, dy deri tre mijë nga Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë.

Pra, shifrat janë të vogla, por sfidat janë të mëdha.

[Narrator]

Hyle Polaci është pjesëtare e komunitetit Rom, e kthyer në Pejë nga Mali i Zi

[Hyle Polaci]

Më heret kemi jetuar në Pejë. Pas konfliktit kemi jetuar në Mal të Zi. Jam shumë falenderuese për ju (UNHCR) që na keni respektuar dhe na keni kthyer në shtëpi.

Na keni ndërtu shtëpi të mira, por do të doja më shumë ndihmë sepse ne jemi njerëz të varfër. Nuk kemi mundësi me fitu vetë. Faleminderit. Ju dëshiroj gjitha të mirat për të gjithë.

[Gazetari]- Si i keni kushtet këtu?

Kushtet janë shumë të mira. E vetmja që na mungon është punësimi dhe ndihma.

Përndryshe nuk kemi ankesa. Duke ju falenderuar juve, ne kemi shtëpi, tokë

[Narrator]

Pavarësisht vështirësive për punësim, të kthyerit janë të kënaqur që kanë marrë shtëpi. Miradie Isaku, pjesëtare e komunitetit Rom e cila u kthye në Klinë nga Mali i Zi, krahason kushtet e saj të jetesës pas kthimit.

[Miradie Isaku]

Nuk ka qenë mirë atje. Kemi jetuar në kontejnerë, pastaj prej kontejnerëve na kanë dergu në tenta e pastaj në barraka. Nuk kemi pase jetë të mirë. Dëshira jonë ka qenë të kthehemi në vendin tonë. Të jetojmë në vendin tonë.

[Narrator]

Sekretari i Përgjithshëm Ban Ki-moon ka bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar që të intensifikojnë përpjekjet për të parandaluar dhe zgjidhur konfliktet dhe për të ndihmuar arritjen e paqes dhe sigurisë në mënyrë që familjet të mund të ribashkohen dhe refugjatët të mund të kthehen në shtëpi

Agjencia e OKB-së për Refugjatë në Kosovë, gjatë këtij viti ka ndihmuar më shumë se 80 njerëz të kthehen deri më tani. Kjo agjenci ka në plan të vazhdojë të punojë për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për të gjithë ata që duan të kthehen në shtëpi.